



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 18.12.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Nezir Çoçaj dhe Jelena Bontiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Shaban Murturi, Edita Kusari, Blerta Bejtullahu, EUSR/EU; Besiana Dauti, Ekonima Online; Erblina Ajazi, Kuvend; Jehona Krasniqi, KDI; Valdrina Duraku, Arjetë Igrishita, Gentrit Statovci, Kaltrina Mustafa, Sara Çunaku, Diellza Shabani, Ulpiana Lajçi, Muhamet Veliu, Laura Zeka, Majlinda Bashota, Marigona Avdyli, Eriona Krasniqi, Korab Muhadri, Sadri Emërllahu, Vjosa Miftari, Arbenita Bytyçi, Mevlude Zeqiri, Drita Gashi, Blerta Cakolli, Donat Hashani, Egzon Krasniqi, Gresa Dreshaj, Blerina Krasniqi, Herolind Osmanollaj, Fatlume Smajli, Vlora Bejiq, Nora Dragaqina, Flora Bejta, Ardita Hamza, Elira Latifaj, Sokol Ejupi, Ariana Bejiq, Blerta Qerimi, Rrezon Gërguri, Shpëtim Beqiri, Ali Daka, Ylli Sokoli, Hëna Rexhaj, UP; Lavdim Bajraktari, IKD; Tringa Ahmeti, Shpat Krasniqi, SKV; Mimoza Musa, UMIB; Donjeta Beqiri, Kolegji Biznesit.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 30.10 dhe 6.11.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-091 për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;

4. Votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës, me kandidatët për drejtor dhe zëvendësdrejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave;
7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi miratimin e rendit të ditës, pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 30.10 dhe 6.11.2018

Kryesuesja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 30.10 dhe 6.11.2017, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-091 për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Sami Kurteshi, tha se grupi punues ka shqyrtuar plotësim-ndryshimin e këtij ligji. Në grupe punuese kanë qenë të ftuar edhe palë të tjera të interesit, duke theksuar se janë dëgjuar edhe palët që kundërshtojnë një veprim të tillë, ku janë shprehur rezervat në lidhje me atë se a janë të garantuara të gjitha siguritë për të pandehurit kur dihet se është gjykim në mungesë. Meqenëse nga Qeveria nuk është sjellë plotësim-ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale, deputeti Kurteshi propozoi që ky plotësim-ndryshim të shqyrtohet dhe të miratohet nga komisioni.

Kryetarja, tha se meqenëse Draft-Kodi i Procedurës Penale nuk është sjellë në Kuvend, atëherë komisioni ka për obligim ta shtyjë përpara këtë plotësim-ndryshim, qoftë me rekomandim pozitiv ose negativ. Është dashur më herët që të trajtohen krimet e luftës, prandaj konsideroj se duhet të ekzistojë gjykimi në mungesë, kur dihet se Serbia nuk i dorëzon kriminelët e luftës, theksoi deputetja Albulena Haxhiu.

Hajdar Beqa, tha se nuk është kundër kësaj nisme, por që të mos ketë shumë plotësim-ndryshime, është dashur të presim, derisa Qeveria ta sjellë Projekt-Kodin e Procedurës Penale në Kuvend, ku janë të përfshira edhe nenet që janë në këtë nismë. Megjithatë, z. Beqa theksoi se në këtë fazë do ta përkrahë.

Shkumbin Demaliaj, tha se edhe gjatë leximit të parë ishte kundër, për shkak se Kushtetuta, brenda normativit të saj, propozon që çdo i akuzuar të ketë të drejtë për t'u mbrojtur. Ai shtoi se gjykatat mund të marrin aktgjykime në mungesë, por më mirë do të ishte sikur t'i shpallim

ata persona në kërkim, në mënyrë që të mos dërgojnë përfaqesues ligjorë, në lidhje me rastin e tyre, kur dihet se edhe dëshmitarët janë të hendikepuar. Pra, do të ketë vetëm stërzgjatje të procedurave, shpenzime të panevojshme dhe në fund nuk do të ketë rezultat.

Arben Gashi, tha se nëse komisioni miraton këtë plotësim-ndryshim, ndryshojmë Kodin e Procedurës Penale në fuqi dhe pas dy muajve miratojmë Projekt-Kodin e ri të Procedurës Penale, atëherë shtrohet pyetja, pse duhet ta bëjmë këtë projektligj, kur nuk do të mbërrijë të hyjë fare në fuqi?

Sami Kurteshi, tha se ky plotësim-ndryshim ka perspektivën e viktimave, d.m.th. njerëzit të cilët kanë pësuar në çfarëdo mënyre, të kenë satisfaksion me gjykimin e njerëzve që kanë kryer vepra. Po ashtu, deputeti Kurteshi theksoi se në këtë plotësim-ndryshim iu është ofruar garanci më shumë sesa që është në disa ligje të vendeve tjera evropiane.

Frashër Krasniqi, tha se në parim është për këtë plotësim-ndryshim, por shtoi se ka qenë e panevojshme të humbet kohë me këtë plotësim-ndryshim, kur e dimë se po presim Kodin e ri të Procedurës Penale.

Kryetarja sqaroi se Kuvendi i Kosovës ka pasur një debat për të pagjeturit, ku është votuar një rezolutë. Pika 11 e kësaj rezolute ka kërkuar që Kuvendi, Qeveria të ndërmarrin nismë ligjore për gjykimin në mungesë të krimeve të luftës, ku si grup parlamentar kemi nisur plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës, pa qenë në dijeni se cila është strategjia legjislative e Ministrisë së Drejtësisë, prandaj mendoj se si komision duhet ta procedojmë për seancë, theksoi deputetja Albulena Haxhiu.

Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetarja konstatoi se me gjashtë vota “për” dhe “dy” kundër, procedohet në komisionet kryesore raporti me amendamente për Projektligjin nr.06/L-091 për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

4. Votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës, me kandidatët për drejtor dhe zëvendës drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Kryetarja, në lidhje me këtë pikë, tha se emrat e propozuar nga Qeveria janë: Naser Shala dhe Florije Kika, për pozitën e drejtorit, ndërsa Albiona Maloku dhe Milaim Çekaj, për pozitën e zëvendës drejtorit. Në lidhje me këtë, deputetja Haxhiu njoftoi anetarët e komisionit me letrën, të cilën e ka marrë nga Ambasada e Britanisë, ku kjo ambasadë për pozitën e drejtorit ka vlerësuar se si kandidatë e vetme, e përgatitur për këtë pozitë, është Florije Kika, ndërsa për zëvendës drejtor ka vlerësuar tre kandidatë të përgatitur për këtë pozitë: Albiona Maloku dhe Mark Buzhala, të renditur me pikë të njëjta dhe Enis Berisha, i ranguar në vendin e tretë, ndërsa propozimet që kemi marrë nga Qeveria, janë: Albiona Maloku dhe Milaim Çekaj, por mungojnë Enis Berisha dhe Mark Buzhala. Vendimi i Qeverisë është në shpërputhje me marrëveshjen e nënshkruar me Ambasadën e Britanisë, prandaj është e papranueshme që në këto institucione po shkojnë njerëz të partive politike, theksoi znj. Haxhiu.

Shkumbin Demaliaj, tha se është mirë të hapim rrugë, që këta emra të shkojnë në Kuvend e pastaj deputetët të vendosin më tutje.

Korab Sejdiu, tha se Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë një marrëveshje, që të përmirësojë emërimet që bëhen në institucione kyçe të vendit, por fatkeqësisht një marrëveshje të tillë po e shkel Qeveria, duke injoruar rekomandimet e një organi kompetent për vlerësimin e kandidatëve. Në rastin konkret, është për keqardhje, sepse është injoruar tërësisht rekomandimi i ambasadës. Pra, Qeveria duhet të reflektojë ose mos t'i nënshkruajë këto marrëveshje. Ai propozoi që të dërgohet një rekomandim në Qeveri, që t'i zbatojë marrëveshjet që nënshkruan. Po ashtu, theksoi se është e padrejtë që personat, të cilët janë të renditur me pikë të larta, të mos shkojnë në Kuvend. Ai propozoi që emrat e tyre të rekomandohen për në seancë.

Arben Gashi, dha propozim që komisioni t'i rekomandojë Kuvendit, që të mos miratohen këta emra.

Hajdar Beqa, në lidhje me këtë pikë, tha se nuk kanë të drejtë të seleksionojnë emrat, prandaj propozoi që të votohen këta emra në pako, e pastaj seanca të vendosë për zgjedhjen e tyre.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me katër vota "për", katër "kundër" dhe një "abstenim", nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të mos emërohen drejtor dhe zëvendësdrejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, asnjëri nga kandidatët e propozuar.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin nr. 06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje për këtë raport.

Meqë nuk kishte diskutime, kryetarja konstatoi se komisioni, me pesë vota "për", dy "kundër" dhe "një" abstenim, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1.Projektligji nr. 06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2.Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave

Kryetarja paraqiti raportin me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen, nëse kanë vërejtje për këtë raport.

R e k o m a n d i m

1.Projektligji nr. 06/L-105 për tatimin ne te ardhurat e korporatave dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2.Projektligji dhe amnedamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional në Projektligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen, nëse kanë vërejtje për këtë raport.

Meqë nuk kishte diskutime, kryetarja konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1.Projektligji nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe amendamentet janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2.Projektligji dhe amnedamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës, kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit se më datë 24.12.2018, komisioni do të organizojë një koktel për festat e fundvitit, ku të ftuar do të jenë organizatat që kanë mbështetur Komisionin për Legjislacion, si dhe mediat që kanë përcjellë punën e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu